



## **KUVENDI I KOMUNËS** **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

### **EKSTRAKT**

**nga procesverbali i mbajtur më 2 qershor 2016, në mbledhjen e XXIV (njëzetekatër) të Komitetit për Komunitete.**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.00’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti Bahri Selimi, Shaban Osmani, Radisav Perović, Xhafer Ademi, Mefail Rama dhe Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Devolle Topçiu, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Nexhmedin Feta, Policia e Kosovës, Bekim Karaxhija, OSBE dhe Gabor Horvatia, KFOR, LMT.

#### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

#### **2. Informatë për vizitën komuniteteve pakicë dhe shkollave në fshatrat Batllavë, Orllan dhe Metergoc – lagjja e Sekiraqëve**

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, e paraqiti fjalën hyrëse.

**z. Xhafer Ademi**, theksoi, në vizitat komuniteteve në fshatrat përkatëse kemi qenë bashkërisht shumica e anëtarëve të këtij Komiteti.

Në Shkollën fillore “ Luigj Gurakuqi “ në Batllavë jemi takuar me drejtorin e shkollës i cili na ka informuar për gjendjen në zhvillimin e procesit arsimor dhe numrin e nxënësve të komuniteteve RAE. Sipas drejtorit të Shkollës vijimi i nxënësve është i mirë dhe se nuk ka probleme të theksuara.

Në Shkollën fillore “ Zahir Pajaziti “ në Orllan nga ana e zëvendës drejtorit të Shkollës jemi informuar se asnjë nxënës i komuniteteve RAE nuk ishte duke i vijuar mësimet përveç dy nxënësve në procesin parashkollor.

Në Metergoc – lagjja e Sekiraqëve, gjendja ishte e mirë dhe banorët e asaj lagjeje nuk kishin probleme të theksuara.

Përndryshe vizita ishte e suksesshme duke e parë për së afërmi gjendjen e komuniteteve dhe nxënësve në shkollat përkatëse, pra gjendje është e mirë dhe siguria në nivelin e duhur.

### **3. Shqyrtimi i mundësive për organizimin e kontrollit shëndetësor të komuniteteve RAE.**

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, e paraqiti fjalën hyrëse.

**z. Halit Vërshefci**, theksoi, nuk ekzistojnë kushtet për organizimin e kontrollit shëndetësor në terren të komuniteteve RAE përderisa objekte shëndetësore ka të mjaftueshme në të cilat stafi mjekësor punon në dy ndërrime dhe janë mundësitë e të gjithë banorëve të bëjnë kontrole mjekësore në çdo kohë.

Sa i përket barnave të gjithë qytetarët mund të furnizohen me barna të cilat janë në kuadër të listës esenciale të barnave.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi, ne jemi duke shqyrtuar mundësitë që komunitetet RAE, për shkak të gjendjes së rëndë sociale, të furnizohen me barna edhe jashtë listës esenciale.

**z. Halit Vërshefci**, theksoi, e ceka më parë se me barnat të cilat janë në listën esenciale mund të furnizohen të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës, pa dallim etnie.

**z. Shaban Osmani**, theksoi, furnizimi me barna nga lista e esenciale është i rregullt për të gjithë qytetarët mirëpo konsideroj se për shkak të gjendjes së rëndë të komuniteteve RAE do duhej shqyrtuar të gjitha mundësitë që kësaj kategorie t'i sigurohen barna edhe jashtë listës esenciale të barnave.

Në këtë kontekst ju informoj se më 5 maj 2016, numrit prej 60 pensionistëve të anëtarësuar në Shoqatën e pensionistëve pas kontrollit mjekësor, për katër lloje të sëmurjeve, u janë dhënë barnat falas dhe atë nga donacioni i një barnatoreje e z. Bedri Novosellës me seli në Prishtinë. Sërisht më 3 qershor 2016 duke filluar nga ora 11,00 kemi organizuar kontrole mjekësore të pensionistëve kuptohet me ofrimin e barnave përkatëse, andaj unë e kam një ofertë konkrete për pjesëtarët e komuniteteve RAE që të vijnë të kontrollohen dhe 10 prej tyre të cilët kanë nevojë do t'ju jepen barnat falas, pavarësisht se a janë të anëtarësuar në Shoqatën e pensionistëve, kriter i cili vlen për komunitetin shumicë.

**z. Liman Zeqiri**, theksoi, nëse i referohemi kësaj teme jam i mendimit se në Komunën e Podujevës është një rrjet shumë i mirë i infrastrukturës i sistemit shëndetësor publik, është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Podujevë dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare që punojnë 24 orë dhe atë në Orllan, Lluzhan dhe Kërpimeh, pastaj janë edhe 18 ambullanta të shtrira në gjithë territorin e Komunës dhe në bazë të kësaj lirshëm mund të themi se Komuna e Podujevës sa i përket rrjetit shëndetësor publik është një prej komunave më të mira.

Po ashtu jemi në dijeni se kontrollet shëndetësore në sistemin shëndetësor publik për të gjithë qytetarët janë pa pages, pa kurrfarë dallimesh.

Sa i përket barnave nga lista esenciale mund të them se edhe spitalet nga një herë kanë probleme me furnizim me barna nga lista esenciale por edhe me barna për sëmurje të rënda siç është rasti me tumore malinje dhe sëmurje të tjera të cilat e kanë koston shumë të lartë, mirëpo pavarësisht nga kjo qytetarët duhet të informohen për mundësinë e furnizimit me barna përkatëse gratis.

Konsideroj se duhet pasë, të them tolerancë, për të gjithë ata njerëz të cilët janë në gjendje më të rëndë ekonomike, gjendje e shkaktuar nga papunësia.

Kontrollimet sistematike, që janë edhe në Planin e veprimit, bëhen më shumë në rastet e epidemive të ndryshme, mirëpo në rastet e veçanta janë të tjera siç është rasti i banorëve të fshatit Metergoc – lagjja e Sekiraqëve të cilët kryesisht janë të moshuar një kohë është dashtë që prej Orllani të dërgohet mjeku çdo dy javë për kontrollimin e atyre qytetarëve, kjo ka qenë pas luftime kur lëvizja ishte paksa më e kufizuar, mirëpo është një kohë e gjatë që një veprim i tillë nuk është i nevojshëm ngase lëvizja e të gjithë qytetarëve është e lirë dhe e sigurve.

Po e përsërisë më e rëndësishmja është të informohen qytetarët se është e drejtë e tyre e pakontestueshme për furnizim me barna nga lista esenciale qoftë Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare apo cilëndo ambulante.

#### **4. Ngritja e grupit për sensibilizimin dhe mbështetjen e maturanëve të komuniteteve RAE të cilët e përfundojnë shkollimin e mesëm të lartë për regjistrim në studime – fakultete**

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi, mbrëmë në një emision televiziv e kam dëgjuar se ka raste që pjesëtarët e komunitetit shumicë e marrin vërtetimin se janë pjesëtarë të komunitetit ashkali dhe regjistrohen në fakultete dhe marrin bursa, kjo ka ndodh edhe në Podujevë që është e padrejtë.

**z. Shaban Osmani**, theksoi, pjesëtarët e komuniteteve RAE të cilët e kryejnë shkollën e mesme janë të favorizuar dhe mund të regjistrohen në fakultete të ndryshme duke përfshirë edhe regjistrimin në shkolla të mesme që në Podujevë regjistrohen pa provime pranuese.

Unë besoj se ka rast që në Komunën tonë ndonjë shqiptar e ka marrë vërtetimin se është pjesëtar i komunitetit RAE dhe është regjistruar në ndonjë fakultet.

Sa i përket çështjes për të cilën jemi duke debatuar janë i mendimit që të propozohen tre anëtarë të këtij Komitete, të ngritet një Grup dhe atëherë sa ka mundësi t'i mbështesin pjesëtarët e komuniteteve RAE kandidatë për regjistrim në shkolla të mesme dhe fakultete.

**z. Xhfer Ademi**, theksoi, ne mund të ngritim sa të dëshirojmë grupe të ndryshme mirëpo nuk mund të realizojmë qëllimin e synuar, këtë e them nga përvoja e vitit të kaluar ngase kjo çështje është në kompetencë të MASHT – it, prej këtu nuk mund të dirigjohet asgjë. Vitin e kaluar jam munduar me të gjitha mundësit, kam kontaktuar e deputetët e përkatësisë tonë etnike të cilët më kanë premtuar për ndihmë duke përfshirë edhe premtimet e përfaqësuesve të MASHT – it, mirëpo e gjitha ka dështuar ngase asnjë kandidat nuk është regjistruar në ndonjë fakultet.

Nga radhët e komuniteteve RAE janë tre persona të cilët vitin e kaluar nuk janë regjistruar në ndonjë fakultet por janë edhe tre të tjerë të cilët këtë vit e përfundojnë shkollën e mesme e që të gjithë do t'i nënshtrohen provimeve pranuese në fakultete.

Dy vitet e fundit nga Komuna e Podujevës nuk është regjistruar në ndonjë fakultet asnjë student i përkatësisë të komuniteteve RAE, por nga radhët e këtyre komuniteteve janë regjistruar nga Ferizaj, Lypjani, Prizreni e komuna të tjera të cilat i kanë deputetët në Kuvendin e Kosovës.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi, ministri i MASHT – it ka thënë do i ndihmojmë komunitetet pakicë për regjistrim në fakultete vetëm të mos bëhen malverzime me vërtetime dhe shtoi, unë jam i informuar se edhe në Komunën e Podujevës janë lëshuar vërtetime të atilla, prej kujt nuk jam në dijeni.

**z. Xhafer Ademi**, vërtetimet lidhur me përkatësinë etnike janë lëshuar nga ana ime dhe z. Liman Zeqiri, shëf i Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim, i cili edhe i ka nënshkruar në bazë të dëshmimeve të cilat ia kam ofruar dhe garantoj se përveç pjesëtarëve të komuniteteve RAE askush tjetër nuk e ka marrë vërtetimin për regjistrim në fakultetet apo për marrjen e bursës.

**z. Liman Zeqiri**, theksoi, çfarë është bërë me vërtetimet e cekura më parë nuk është e drejtë e imja të them dhe as që paragjykoj asgjë.

Për lëshimin e vërtetimeve të cekura unë e kam përdorë një metodë që është pëlqyer edhe nga komunat tjera, e ajo është që vërtetimet janë lëshuar në bazë të fotokopjeve të letërnjoftimeve të aplikuesve, babës dhe nënës, numrat personal të tyre, përveç kësaj edhe pse kam qenë në dijeni e ka kërkuar edhe dëshminë në formë të shkruar nga kryetari i Komitetit të fshatit dhe në vijimësi për çdo rast jam konsultuar me z. Xhafer Ademin dhe dëshiroj të shtoj edhe këtë se për çdo vërtetim të lëshuar është dosja me të dhënat komplete të cekura më lartë.

**z. Bahri Selimi**, theksoi, çështjen të cilën e ngriti kryesuesi z. Shaban Ahmeti, ai duhet ta mbështet në fakte dhe nëse ato vërtetohen atëherë mbetet përgjegjësi e organeve kompetente të merren me atë çështje.

Lidhur me çështjen për të cilën jemi duke debatuar, në rend dite të cilin e miratuam më parë shkruan, ngritja e grupit për sensibilizimin dhe mbështetjen e maturanëve..., pra jo ngritja e grupit për t'i regjistruar maturanët në fakultete kur dihet se kush është kompetent për regjistrim në fakultete. Sipas mendimit tim për 6 maturanët të cilët i kanë mundësitë të regjistrohen këtë në fakultete këtë vit ne mund t'iu ofrojmë një trajnim lidhur me formën dhe metodën e testit pranues në fakultete.

**z. Mefail Rama**, theksoi, Universiteti i Prishtinës i ka rregullat e veta specifike në këtë kontest përfshihet numri i caktuar për regjistrim nga radhët e komuniteteve RAE, mirëpo për këtë nuk janë të informuar të gjithë aplikantët.

Gjatë diskutimit u përmend se më së shumti regjistrohen nga Prizreni, Ferizaji e komuna tjera, mirëpo duhet pas parasysh se kur të plotësohet numri i cili është i kufizuar atëherë nuk ka mundësi për regjistrime shtesë.

**5. Shqyrtimi i mundësive për organizimin e një takimi pune me përfaqësuesit e Komiteteve për Komunitete të komunave të regjionit të Mitrovicës ( sipas organizimit territorial të OSBE – së ).**

**z. Bekim Karaxhija**, theksoi, këtë çështje e konsideroj si kërkesë të këtij Komiteti për Komunitete dhe porsa të shkoj në zyrë do të bisedoj me shefin dhe në ndërkohë, përmes Zyrës ligjore, do t'ju lajmëroj se a ka mundësi OSBE të organizoj takimin e cekur.

**6. Të ndryshme**

Nuk pati diskutime.

**Mbledhja përfundoi në orën 12.05'.**

**Procesverbalin e mbajti  
Faik Gashi**

**Nr. 01-006-53061  
Podujevë,  
2 qershor 2016**

**Kryesuesi i Komitetit  
Shaban Ahmeti**